



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2022

**Procesverbal**

**Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022**

**Më 05.05.2022**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Sabedin Vishi**, Nënkyryetar i Komunës

**Zija Bela**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Fidaim Fazliu**, Bashkësia Islame

**Zahir Doda**, Drejtor i DAK

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Ylber Tusha**-Përfajqsuesi i Bizneseve

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Raport dhe vlerësim i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Trotuaret , lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese
- 4.Qent endacak
- 5.Diskutim rrreth mundësisë së mbajtjes të një takimi publik me qytetarë kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, rrreth sigurisë publike
- 6.Të ndryshme
  - 1.Procesverbal u miratua nga të pranishmit

**2.Raport dhe vlerësim i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi rreshter **Zija Bela** i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile por që i kemi gjithsejtë 58 raste të veprave penale ku prej tyre më të theksuara kanë qenë vjedhjet -12 raste ,vjedhje e rëndë 11 raste ,zjarrvënje 8 raste ,kanosje etj.

Janë zbuluar 33 raste që janë dorzuar në prokurori .

Vjedhje e Rëndë ka ndodhur në Xhamin e fshatit Duraj ku të dyshuarit janë zënë dhe janë dërguar para drejtësisë .

Ligjératat janë duke vazhduar nëpër shkolla në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit dhe kryesisht janë tema që trajtojnë dukuritë negative në shoqëri.

Kemi filluar nga muaji shkurt e përfundojmë në maj dhe përsëri me ligjérata fillojmë në muajin tetorë e nëntorë .

Në këtë periudhë kohore kemi lëshuar gjithsej 326 tiketa në trafik.

Problematikë që na është shfaqur është mos funksionimi i kamerave të sigurisë cilat janë shumë të nevojshme për zbulim të rasteve .

**Menduh Krasniqi** -Nuk jamë pjesë e KKSBB-së por që në bazë të temave që jam njoftuar që do të trajtohen në këtë takim e pashë të arsyeshme të jemë prezent dhe të kontriboj në trajtimin e këtyre temave.

Jam shef i inspektoratit komunal dhe deshta ta njoftoj përfaqësuesin e Policisë se në kuadër të sektorit të inspektorëve komunal kemi ekspert të lëmive përmbrrojtjen e mjedisit dhe të trafikut dhe mundë të logaritni në ndihmën tonë nëse ndonjëher keni për të trajtuar këto tema.

**Zija Bela**-Programin mbi mbajtjen e ligjératave nëpër shkolla e përcakton drejtoria e përgjithshme e Policisë së Kosovës dhe kemi tema që përcaktohen nga kjo drejtori .

Ne jemi për bashkëpunim me çdo institucion që shfaqë interesin në trajtimin e temave që parandalojnë dukurit negative në shoqëri.

Në pikën e tretë të rendit të ditës Kryetari i dha fjalën Drejtorit të shërbimeve publike dhe Emergencë i cili edhe pse nuk është anëtar i K.K.S.B-së ,ishte i ftuar që të merr pjesë në këtë takim pasi që temat e këtij takimi kanë të bëjn me këtë drejtori .

### **3.Trotuaret , lirimi i tyre dhe shenjat sinjalizuese**

**Ramadush Osmani-Trotuaret** janë nën domenin e drejtorisë së shërbimeve publike dhe mundë të japë disa informacione që kanë të bëjnë me trotuaret.

Në planet e sivjetme të drejtorisë hynë edhe ndërtimi i dy trotuareve, një në Stagovë dhe një ne Gerlicë e Bajnicë .Sa i përket çështjes së lirimit të trotuareve mundë të ju them se trotuaret nuk janë të bllokuara pos përballë Viva marketit ku një pjesë e trotuarit është pronë private dhe paraçet pengesë. Sa i përket çështjes së shenjave sinjalizuese , ne kemi një kontratë me një kompani për vendosjen e shenjave dhe në momentin që e shohim të arsyeshme që në një vendë ka nevojë ,atëherë marrim masa dhe i vendosim këto shenja .

**Shemsedin Abazi-Kam** një kërkesë që te kompleksi i varrezave të dëshmorëve të vendoset një shenjë orientuese që tregon vendin e stadionit të qytetit ngase ekipet musafire që zhvillojn ndeshjet e futbollit po e kanë problem me u orientu.

**Kryetari-Kemi** kërkesa të vazhdueshme për trotuare dhe për parkingje por që për mungesë të hapsirave të mjaftueshme nuk po kemi mundësi që të i plotësojm këto kërkesa të nevojshme.

Ne jemi munduar që sidomos në kohën kur mërgimtarët i kemi këtu të krijojmë hapsirë te stacioni i autobusve dhe oborrin e shkollës fillore Emin Duraku.

**Naim Hysa-Më** intereson të dijë që gjatë ndërtimit të barrierave në rrugë a keni ndonjë kriter ngase po më duket se në disa pjesë janë jashtë standardit.

**Ramadush Osmani-Kërkesa** për pengesa në rrugë kemi shumë ,por që ne brenda drejtorisë kemi rregullore që përcakton kriteret e ndërtimit të këtyre barrierave .

Nëpër ato rrugë që ka trotuare do të marrim vendim me i largu barrierat.

**Jashar Selimi:** Është mirë që çdo individ që vjen e kërkon nga ju vendosjen e Policëve të shtrirë ,të i tregoni procedurat dhe rregullat që duhet të ndjekë me rastin e paraçitjes së kërkesave.

**Fidaim Fazliu-** si shkak i ndërtimit të këtyre pengesave në rrugë disa vozitës të pandërgjegjshëm po devijojnë edhe rrugën dhe po rrezikojnë qytetarët në hapsira tjera duke ju ikur këtyre pengesave.

**Kryetari-Është mirë të vedi si qytetarët që tē lajmrojnë rastet, kur tash ju mundësohet edhe përmes inqizimeve dhe fotove tē lajmërojnë këto rastet.**

**Zija Bela-Kjo** është mirë që qytetarët tē lajmrojnë por që telefonat nuk janë mjet bindës për organet e drejtësisë për tē matur shpejtësinë e automjeteve dhe ne nuk dalim mirë nëse e paraçesim si dëshmi këtë formë.

#### **4.Qent endacak**

**Kryetari-Këtë temë e kemi diskutuar pothuajse në çdo takim por pasi që e kemi me plan tē punës fjalën ja japim Bujarit i cili është marrë me qështjen e qenëve endacak.**

**Bujar Bajra -Kompania** që mirret me trajtimin e qenëve endacak ka bërë një kontratë dy vjeçare me komunën tonë dhe kjo kontratë skadon më 21 shtatorë 2023.

Faza e parë është kryer e poashtu edhe faza e dytë dhe deri më tani janë trajtuar mbi 100 qenë endacakë .Deri më tani planet e ofruara nga niveli qendrorë kanë dështuar dhe në bazë të informatave që kam është duke u punuar në një strategji kombëtare për trajtim human tē geneve endacak.

Parashihet që në këtë strategji tē identifikohen tē gjithë qentë endacak tē cilët do tē trajtohen dhe do u vendoset nga një vathë , do tē identifikohen pronarët për tē cilët do tē ketë masa ndëshkimore nëse nuk ju përbahen rregullave tē strategjisë .

Kam bërë një hulumtim në Q.K.M.F dhe në bazë të informatave që kamë marrë vetëm këtë vit janë kafshuar nga qentë endacak 18 qytetarë.

**N.Hysa-Më** intereson tē dijë se si mundë tē vërtetohet se kompania e ka bërë trajtimin.

Ata mund ti kapin qent , u vendosin vathë por si mundë ta dijmë që i është bërë trajtimi i duhur.

**Bujar Bajra-E** kam monitoruar procesin ku përmes formës së vërjes në gjumë ata e bëjnë edhe trajtimin, duke u vendosur vathë dhe prapë i kthejn në vendet ku i kanë marrë.

**Ramadush Osmani – Problemi** është me qentë me pronarë tē cilët për shembull dy i ruajn e katër i lëshojnë dhe nga kjo bëhet shtimi i qenëve endacak.

**Kryetari** – Ne kemi mbetë një vend eksperimental .Deri sa vendet tjera kan gjetë forma duke ju bërë trajtimin e duhur, duke siguruar strehimore dhe staf për mbykqyrje, ne nuk e kemi atë mundësi ngase është i kushtueshëm ky trajtim.

#### **5.Diskutim rreth mundësisë së mbajtjes tē një takimi publik me qytetarë kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, rreth sigurisë publike**

**Kryetari** -Në kuadër tē planit tē punës së K.K.S.B së në muajin prill kemi parapaërtë mbajë një diskutim publik me qytetarë për çështjen e sigurisë në Komunën tonë por për shkak se ky muaj

ishte Ramazan mendova që ketë diskutim publik ta zhvendosim për muajin Maj ose Qershorë nëse pajtoheni edhe ju.

Me këtë propozim të kryetarit u pajtuan të gjithë dhe mbetet që të bëhen përgatitjet përfshira dhe njofitimet publike.

#### **6.Të ndryshme**

**Fatmir Qaka – U Përmend se kamerat e sigurisë nuk janë funksionale gjë e cila është shqetësuese .**

Më intereson ta dijë se a janë funksionale kamerat e sigurisë në bulevardin Ismajl Raka ngase unë shohë se në korzën e katërt ulset të gjitha janë të shkatërruara dhe atë qëllimi shkaktohet.

Shqetësim tjetër është magjistratja sidomos ku ka hyrje e dalje në Bob , a egziston mundësia për shtrimin e një kërkese në Ministrin e Punëve të Mbrendshme përvendosjen e një shenje në hyrje dhe dalje të Kaçanikut përgadalësim të shpejtësisë , ngase shpesh po ndodhin aksidente.

**Zija Bela – Sa i Përket çështjes së parë me keqardhje mund të them se 90% e kamerave të sigurisë nuk funksionojnë , gjë e cila po na i vështirson punën tonë në zbulimin e rasteve , ndërsa sa i përket shenjës përgadalësim të shpejtësisë në hyrje dalje të Kaçanikut në pjesën e magjistrales ,kërkesa mundë të bëhet dhe të i përcillet nivelit qendëror.**

**Fidaim Fazliu- Kryetar ku është arsyaja që këto kamera të sigurisë nuk funksionojn dhe nuk mirëmbahen.**

**Kryetari-Në kohën kur e kemi pasur kompetencën ne si komunë , përmes donatorëve kemi siguruar këto kamera dhe janë mirëmbajtur nga ana jonë , por që tash kamerat e sigurisë janë nën kompetencat e MPB-së dhe ata duhet të kujdesen përmirësuar këtë situacion.**

**Menduh Krasniqi-Si komunë kemi bërë kërkësë që në disa vende rreth magjistrales ku ne e kemi parë të arsyeshme të ndërtohen shirita të komunikacionit , por që nuk jemi marrë në konsideratë nga niveli qëndrorë.Deshta me u ndërlidh edhe në qështjen e zhurmës së natës ku kemi shumë ankesa nga qytetarët,ne kemi pasur takim edhe me stacionin policor dhe e kemi biseduar këtë çështje.**

**Ne si inspektoriat nuk e kemi atë të drejt të intervenojmë ngase nuk na e mundëson ligji . Ligji mbi zhurmën me sa kam informacion ende nuk ka kaluar ne Kuvend të Kosovës .**

**Policia në bazë të ligjit për ruajtje të rendit dhe qetësisë publike mundë të intervenoj në pengimin e kësaj dukurie.Për matjen e zhurmës në bazë të ligjit duhet me qenë person i licensuar nga kompanit që e bëjn kët punë.**

**Kryetari-Inspektorati dhe Policia mundë të veprojn te ato lokale që nuk respektojn orarin e punës.**

Ankesat vijnë kryesisht pas orës 12 e natës e për ligjin e zhurmës është një çështje tjetër që është kompetencë e nivelit qendrorë.

**Nënkyetari-Të** shkohet e të bisedohet me pronarët e lokaleve, të ju ipet vërejtje por edhe të ndëshkohen , e besoj se edhe situata do të ndryshoj.

**Ylber Tusha-Ka** lokale që frekuentojn edhe nga moshaadoloshente dhe ju shërbehet atyre edhe pije që janë të ndaluara për kët moshë.

Janë disa rregullore komunale që u janë shpërndarë lokaleve , që u ndalohet shërbimi i këtyre pijeve për këtë moshë por që është edhe e përcaktuar që kjo moshë pas orës 21 pa përcjellës nuk guxojnë të jenë prezent në ato lokale.

**Fidaim Fazliu-Ne** si bashkësi Islame kemi pasur takim me Kryetarët e Komunave dhe jemi mirëkuptuar në reduktimin e zërit gjatë thirrjes së ezanit edhe pse kam pasur edhe kundërshti nga një pjesë e Imamëve .

**Zija Bela-Do** ta keni gjithëher përkrahjen tonë nëse kërkohet nga ne të asistojmë në pengimin e çfarðo dukurie që prishë rendin dhe qetësin publike.

#### REKOMANDIMET

- 1.Të zbatohen kriteret për vendosjen e policëve të shtrirë nëpër rrugë
- 2.Të gjinden forma përfunksionalizimin e kamerave të sigurisë
- 3.Të hulumtohen vendet që kanë nevojë për vendosjen e shenjave sinjalizuese
4. Të krijohen hapsira të nevojshme për vend parkingje në qytet
- 5.Të largohen barrierat në rrugë në pjesët që janë të ndërtuar trotuaret
- 6.Tolerancë zero ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat e komunikacionit
- 7.Të monitorohet puna e kompanive që trajtojnë qent endacak
- 8.Të bëhen kërkesa të vazhdueshme nivelit qendrorë për mirëmbajtjen e maxhistralës sidomos në pjesën e territorit të komunës tonë.
- 9.Të mirren masa ndaj pronarëve të lokaleve që nuk respektojnë orarin e punës , krijojnë zhurmë dhe që ju shërbejnë me pije alkoolike moshës adoleshente.

Kryesuesi: Kryetari i Komunës  
z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:  
Fatmir Qaka